



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:282002

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05508782

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.TH., nga fsh. ...K Gjakovë, për shkak të veprës penale sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë PP/II.nr., 1686/23 të datës 14.12.2023 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **26.03.2024**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, si dhe të akuzuarit K.TH., të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **K.TH.**, nga fsh.... K Gjakovë, i lindur me datë ..., nga i ati ... dhe e ëma.. e vajzërisë Krasniqi, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, beqar, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ID ...

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- Më datë 01.11.23, rreth orës 17:00, në rr.... fsh....K.Gjakovë, me dashje përdor forcën fizike ndaj të dëmtuarve E.Th., dhe HTh., në atë mënyrë që ditën kritike përderisa të dëmtuarit ishin duke lëvizur me motoçikletë, i pandehuri K.Th., iu del përpara motoçikletës me qëllim të ndalimit, ku aty fillimisht i drejtohet të dëmtuarës E.TH., me fjalët *'pse po del me djemtë të tjerë po lazdrohesh'* dhe pastaj e godet të dëmtuarën dy here me shuplakë në fytyrë, e kur e njëjta nis për të shkuar në shtëpi, i pandehuri pastaj disa here e godet me shuplakë në fytyrë të dëmtuarin H.Th., ku me këto veprime të dëmtuarve iu shkakton dhimbje fizike,

-me çka ka kryer veprën penale sulmit nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074.

Andaj Gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 2,3, 4, 6, 7, 17, 38, 39 par. 1. nën par. 1.2, neneve 46 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2, nenit 47, 48, 49,50, 69, 70, 71 par. nën. par.1.1 dhe 1.3, nenit 184 par.1 të KPRK-së, si nenit 364 të KPP të Republikës së Kosovës, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **120 (njëqind e njëzet) ditë** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet .

Të dëmtuarit E.TH., dhe Hazir H.TH., nga fsh.... K Gjakovë ,për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **20.00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr. 1686/23 të datës 14.12.2023, ka akuzuar të akuzuarin K.TH., nga fsh. ...Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-ës.

Prokurorja e shtetit Qazim Xharra , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 26.03.2024 lexon aktakuzën PP/II.nr., 1686/23 të dt.14.12.2023 dhe . deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që ky pranim i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,duke i ditur pasojat dhe benefitet e një pranimi të tillë si dhe është bere pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga ana e gjykatës po ashtu faktin se pranim i fajësisë mbështet në faktet e çështjes ,respektivisht provave materiale dhe personale që përmban aktakuza. Lidhur me vendimin për dënim deklaroi se si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i pandehuri ka pranuar fajësinë ,pendimin e shprehur ne gjykatë , premtimi se ne të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, d si dhe faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin ,ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh dashja e lartë ne kryerjen e veprës penale .

I akuzuari K.TH., , gjatë shqyrtimit fillestar deklaroi se ndihem fajtor për veprën penale me të cilën pandehem duke i ditur edhe me parë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë në mënyrë vullnetare dhe pa presion ,shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer në afekt , me qenë se nga ana e tyre siç kam deklaruar edhe ne st.policor jam provokuar duke prishur rendin dhe qetësin për shkak të shëtijëve të vazhdueshme edhe ne orët e natës me motor, kërkojë falje publike nga të dëmtuarit për veprimet e mija ,,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem me i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi fajësisë , pendimin e shprehur për këto veprime të mija , premtim se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin ,te me shqiptojë një dënim me të butë .

2.Vlersimi pranimit të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjyqësore në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari K.TH., , për shkak të veprës penale sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas sqarimit të mjaftueshëm edhe nga ana e gjykatës , pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga Prokurori i shtetit dhe çdo

provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykon në bazë të ligjit ,me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij .

4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 184 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Sulm e kryen: “ 1. *Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.*

5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin K.TH., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70, 71 par.1 nën. par.1.1 dhe 1.3 , që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata konstaton faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës , shkallën e lartë te dashjes , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se i njëjti është moshës relativisht te re, i pa punë, gjendjen e dobët ekonomike, sjelljen e tij korrekte në gjykatë . Ne këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetit i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm korrekt, i e vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, është penduar thellë për veprën penale të kryer në afekt dhe se pas këtij rasti më nuk kanë pasur probleme mes veti . Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar , shprehjen e keq ardhjes , kërkim faljen publike ndaj të dëmtuarve si dhe fakti se nga se Evidenca penale PDP për të akuzuarin, nuk ka të kaluar kriminale , aktvendim apo aktgjykim të formës së prerë.Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese për të akuzuarin , gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit të parapara nga neni 70 të KPRK-së dhe të akuzuarit i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarit E.TH., dhe H.TH., për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike .

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën. par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
2023:282002 me datë 26.03.2024**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.